

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Regj.I.nr.10889/2012

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes ne procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit: Faik Prekazit nga Mitrovica per shkak te kundervajtjes nga neni 5.1.6.3 dhe 9 dhe neni 17 paragrafi 1.3.te Ligjit nr.04/L-050 te Ligjit per deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasuris te Zyrtarve te Lart Publik dhe deklaraten e prejardhjes dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtar, e duke u mbeshtetur ne nenin 30,123,195 dhe 198 te Ligjit mbi kundervajtjet me dt. 30.01.2013 vit. bie kete:

A K T V E N D I M


PEZULLOHET procedura kundervajtëse ndaj te paraqiturit Faik Bislim Prekazi, i lindur me dt. 03.05.1948 vit. ne Mitrovicë ku dhe tani ka vendbanimin rr."Mbreteresha Teute"nr.267/1-5, me profesion jurist dhe Drejtor i Drejtoris se Integritimeve Evropiane dhe Mireqenjes Sociale ne Komunen e Mitrovices, i paraqitur nga Agjencia kunder Korrupcionit per kundervajtje nga neni 5.1,6.3, nenit 9 dhe 17 paragrafi 1.3. te Ligjit per deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurise te Zyrtareve te Lart Publik dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat e lart zyrtar respektivisht per mosdeklarimin e pasuris sipas kerkeses se Agjencise kunder Korrupcionit SEPSE NUK ESHTË KRYES I KUNDERVAJTJES ME TE CILEN NGARKOHET e n'konform 198 al.2 te Ligjit mbi kundervajtjet.

- Shpenzimet e procedures ne shume paushalle prej 5.-(pese) Eurosh i barte Gjykata.
- Me nga nje kopje te ketije aktvendimi te njoftohet parashtuesi i kerkeses kundervajtjes dhe i paraqituri.

A r s y e t i m

AGJENCIA KUNDER KORRUPCIONIT PRISHTINE ka parashtuar kerkese kundervajtëse nr.01-4283/12 te dt.26.11.2012 vit. per zhvillimin e procedures kundervajtëse ndaj paraqitesit Faik Bislim Prekazi per kundervajtje nga neni 5.1,6.3 nenit 9 dhe 17.1.al.1.p.3. te Ligjit mbi deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasuris te Zyrtareve te Larte Publik dhe deklaraten e prejardhjen dhe kontrollin e pasurise te Zyrtareve te Larte Publik dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat e larte zyrtar.

Gjykata me qellim te vertetimit te drejte dhe te plote te gjendjes faktike ka marrur ne pyetje dhe ka degjuar te paraqiturin ne seancen verbale te mbajtur me dt. 24.12.2012 vit. i cili ne mbrojtjen e tij kundervajtjen me te cilen eshte i ngarkuar e kontestoi se nuk ka pasur dijeni dhe askush nuk e ka informuar se kam per obligim per ta paraqitur-pasurin.



Paraqitesi deklaroi: Une kam filluar si thash edhe me larte me punuar ne kete drejtori prej 03.09.2012 vit. dhe sipas ligjit 04/L-050 pasi qe kam kuptuar se ne afatin prej 30 ditesh duhet ta lajmeroj pasurine, kte e kam bere me 26.11.2012 vit. jo per ate qe kam ikur nga kjo deklarate e paraqitjes se pasuris time dhe pa kurfar qellimi por arsyeja eshte qe nuk kam qen i informuar prej askujt. Une per kte qe duhet te lajmeroj pasurin e kam kuptuar ne shtepi kur e kam hapur internetin dhe e kam shkruar emrin tim Faik Prekazi dhe aty kam pa se une dhe 18 persona tjere kishim qene ne ate liste qe nuk e kishim lajmeruar kete pasuri dhe menjehere te nesermen kur kam shkruar ne pune e kam thirrur Fitim Ramen personin pergjegjes i cili ka qene i detyruar qe te me tregoj dhe i njeiti me ka thene se kam menduar se ki afat deri me 31.03.2013 vit. qe edhe une duhet ta plotesoje kete deklarim te pasuris keshtu qe kjo kohe ka qene me 23.11.2012 vit. keshtu qe ditën e hene me dt. 26.11.2012 vit. me iniciativen time Fitim Rama me ka paraqitur ne agjencine kunder korrucionit qka e kam edhe vertetimin te cilin e kam dorzuar me nr.03/3931/12 te dt. 26.11.2012 vit.

Kerkoj nga kjo Gjykate qe pasi qe nuk e ndiej vehten pergjegjes per kundervajtjen e cila eshte paraqitur ne emrin tim te me liroj nga pergjegjesia sepse asnji perqind nuk e ndiej vehten pergjegjes shkeles i Ligjit per kundervajtje.

Gjykata shqyrtoi dhe deklaraten e perfaqesuesit te Agjencise kunder korrucionit Agron Behramit dhe perfaqesuesit te Sherbimit Komunal gjegjesisht Fitim Rames personi pergjegjes i cili ka pasur per detyre qe t'ia dorezoi personit Faik Prekazit kerkesen deklarimin e pasurise.

Deklarata e Koordinatorit te Njisis per te Drejtat e Njeriut ne Kuvendin Komunal ne Mitrovice-ne Drejtorin e Administrates se Pergjitheshme Fitim Rama deklaroi: Une Fitim Rama punoi ne Kuvendin Komunal ne Mitrovice ne Drejtorin e Administrates se Pergjitheshme si Koordinator i Njisis per te Drejtat e Njeriut dhe per rastin e Drejtorit Faik Prekazit i cili eshte pranuar si Drejtor i Drejtoris se Integriteteve Europiane dhe i Mireqenjes Sociale ne Komunen e Mitrovices mund te them: Faik Prekazi eshte emruar Drejtor prej dt.01.09.2012 vit. e tani ku eshte duke punuar ne kete drejtori, dhe per kerkesen per kundervajtje qe eshte paraqitur ne Gjykatën Komunale per Kundervajtje ne Mitrovice nga Agjencioni kunder Korrupsionit deklaroi se une rregullisht ne vitin kalendarik per te gjithe zyrtaret e larte i kam paraqitur dhe i paraqes deri me 31.03.te vitit. E pasi qe Faiku ka ardhur ne 3 mujorin e fundit te vitit ndoshta me gabimin tim duke menduar qe deklarimi duhet te behet deri me 31.03. te vitit vijues dhe duke menduar qe paraardhesi i tij Kastriot Jashari e ka pas te lajmeruar deklaraten e pasuris e ceku kte se Drejtor i tashem Faik Prekazi nuk ka qene i njoftuar qe duhet ta lajmeroj pasurin dhe se sipas mendimit tim ai nuk ka pasur qellim qe ta mshef pasurin pasi qe e dim qe eshte nje gjendje pa pasuri.Pasi qe e konsatoj kete gjendje keshtu kerkoj nga kjo Gjykate qe i njeiti te lirohet nga pergjegjesia sepse nuk ka qen me fajin e tij mosdeklarimi i pasurise.I njeiti pasi qe e ka vrejtur ne kompjuter se Agjencioni kunder Korrupsionit ka bere listen e personave te cilet se kan lajmeruar pasurin menjehere eshte lajmeruar tek une dhe me ka pyetur se a duhet une ta lajmeroj pasurin pasi qe une jam ardhur ne fund te vitit-tremujorin e fundit. I njeiti ka lajmeruar pasurin me 26.02.2012 vit. e ku shenimet jane ne kete lend te Gjykates andaj siq e thash edhe me larte kerkoj nga kjo gjykate qe te lirohet nga pergjegjesia.

Gjithashtu Gjykata e degjoi duke e marrur ne pyetje edhe perfaqesuesin e Agjencise kunder korrupsionit i njeiti deklaroi se i paraqituri ka pasur per detyre qe ta lajmeroi pasurin dhe qendron pran asaj qe paraqitesi te denohet sipas ligjit.

Gjykata pas administrimit te provave, shqyrtimit te kerkeses te inicuar nga parashtuesi i kerkeses e ne baze te dispozitave te nenit 7 te ligjit te sipershenuar me larte i cili nen parasheh deklarimin e zyrtareve me rastin e marrjes se detyres, deklarates se te paraqiturit provave te prezentuara ne séance u vertetua se nuk ka kundervajtje te kryer per te cilen eshte i ngarkuar dhe ne mungese te provave Gjykata vendosi qe ta PEZULLOI procedure kundervajtese ne baze te nenit 198 al. 1 pika 2 te LMK-es.

Me sa eshte cekur me larte eshte vendosur si ne dispozitiv te ketij aktvendimi, me dt. 30.01.2013 vit. Regj.I.nr.10889/2012.

UDHEZIMI JURIDIK: Kunder ketij aktvendimi eshte e lejuar ankesa ne afatin prej 8 ditesh Gjykates se Apelit ne Prishtine- Departamenti i Pergjithshem-Divizioni i Kundervajtjes.

Sekretarja Juridike

Xhemile Babatinci



Gj y q t a r i

Sabit Pllana

Handwritten signature of Sabit Pllana.